

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.B. nga Ferizaj rruga “.....” nr....., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.4 lidhur me par.3 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themeore në Ferizaj PP/II.nr.1492-08/12 e dt.15.04.2013 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt.21.06.2016, në prani të përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Visar Musa dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari F.B. nga Ferizaj rruga “.....” nr., data e lindjes..... në të njëjtin vend, nga i ati I. dhe e ëma F., e gjinisë R., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, me punë të përkohëshme në Gjermani, i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTORË**

**S e p s e:**

Më dt.18.08.2012 rreth orës 21:30, në rrugën “Ahmet Kaqiku”, përballë servisit “.....” në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës “Fiat Bravo” me ngjyrë të zezë me targë të regjistrimit ....., në kundërshtim me dispozitat e nenit 71.1 të LSKRR nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që ka marrë veprimin e tejkalimit pa u bindur mirë se do të rrezikojë pjesmarrësit tjerë në komunikacion, ashtu që ka filluar tejkalimin e autobusit dhe me pjesën e përparme e godet në pjesën e parë të anës së majtë veturën e markës “VW Pasatt” me ngjyrë të kaltërt me tarë të regjistrimit ....., të cilin e drejtonte Sh.N. e cila ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt, me këtë rast pos dëmëve materiale lëndime të rënda trupore ka pësuar A.A. dhe atë: thyerje të kockës së hundës me dislokim e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohëshme të shëndetit.

Me të cilën ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni.297 par.4 lidhur me par.3 të KPK-së.

Gjykata në bazë të neneve 3, 6, 34, 36, 38,64,të KPK-së nenit, 47 të KPRK-së dhe si i dhe nenit 365 të KPPRK-së të akuzuarin e

**G J Y K O N**

**DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 1000 €uro (njëmijë euro), e të cilën gjobë detyrohet që ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet apo i akuzuari refuzon ta paguaj, do të ekzekutohet dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muajve.

I dëmtuari: A.A. nga Ferizaj rr.”.....”, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 81,76 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnim e përmbarim me dhunë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1492-08/12 e dt.15.04.2013 me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin F.B. nga Ferizaj rruga “.....” nr., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.4 lidhur me par.3 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.21.06.2016 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Visar Musa dhe i akuzuari F.B..

Në fillim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drejtat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohe mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari F.B. në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar duke theksuar se është e vërtet se ditën kritike ka ndodhur aksidenti i përshkruar në aktakuz, të dëmtuarin në këtë aksident e kam nip dhe gjendja shëndetësore e tij tani është e mir, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të merrë për bazë pranimin e fajsisë dhe ti shqipton dënim sa ma të butë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, pranimin e ka

bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurri i shtetit Visar Musa deklaroi se nuk kemi vërejtje në pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njejtë pranim i fajësisë është konform nenit 248 të KPPK-së, i propozojmë gjykatës që gjatë matjes së dënimit të ketë parasysh si rrethanat lehtësuese e edhe ato rënduese e si rrethana lehtësuese veqanarisht pranimin e fajësisë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë i datës.24.03.2013, dhe ekspertizën e ekspertit të komunikacionit i datës 12.03.2013 si dhe fotografit që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale.

Meqëse i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par 4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili pranim është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj çështje penale, gjyqtari individual vërtetoi këtë gjendje faktike:

I akuzuari me dt.18.08.2012 rreth orës 21:30, në rrugën “Ahmet Kaqiku”, përballë servisit “.....” në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës “Fiat Bravo” me ngjyrë të zezë me targë të regjistrimit ....., në kundërshtim me dispozitat e nenit 71.1 të LSKRR nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që ka marrë veprimin e tejkalimit pa u bindur mirë se do të rrezikojë pjesmarrësit tjerë në komunikacion, ashtu që ka filluar tejkalimin e autobusit dhe me pjesën e përparme e godet në pjesën e parë të anës së majtë veturën e markës “VW Pasat” me ngjyrë të kaltërt me targë të regjistrimit ....., të cilin e drejtonte Sh.N. e cila ishte duke lëvizur nga drejtimi i kundërt, me këtë rast pos dëmëve materiale lëndime të rënda trupore ka pësuar A.A. dhe atë: thyerje të kockës së hundës me dislokim e të cilat lëndime rezultojnë me pasoja të përkohëshme të shëndetit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.4 lidhur me par.3 të KPPK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPPK-së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e

dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrethanë lehtësuese mori parasysh pranimin e fajësisë për veprën e kryer, është kujdesur për gjendjen shëndetësore të dëmtuarit kërkim falje të dëmtuarëve, shërim pa pasoja, një pranim i fajësisë nga ana e të akuzuarit ka qenë i sinqertfaktin se nuk ka të dhëna se më parë ka qenë i denuar për ndonjë vepër penale. Ndërsa rrethana veqanarisht rënduese gjykata nuk gjeti dhe mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimi në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 par.1 lidhur me par 3.të KPPRK-së, të dëmtuarin A.A. nga Ferizaj rr.”.....”, për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPRK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 81,76 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**P nr.809/2013 me datë 21.06.2016**

**Asistenti**  
Muedin Rexhepi

**Gjyqtari**  
Adem Shabani

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.